



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1271/4 prot

Datë 26.06.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 523/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.06.2023, mori në shqyrtim çështjen me,

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Sead - SGS” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-62788-03-17-2023, me objekt: “*Blerje ushqime*”, me fond limit 10.000.000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra e Zhvillimit Shkodër.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “EL-GJO-2006” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Sead - SGS” SHPK  
Lagja 2, Rruga “Mullishtër”, Godinë 1 katëshe, Kashar,  
Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Qendra e Zhvillimit Shkodër  
Lagja “Skenderbeg”, Rruga “Dr. Ali Spahija”, Shkodër

**Subjekte të Interesuar:**

Operatori ekonomik “EL-GJO-2006” SHPK  
Rruga “Ing. Gjovalin Gjadri”, nr pasurisë 14/202, zona kadastrale 8593, Shkodër

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V ë r e n:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor.

**II**

## *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 22.03.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-62788-03-17-2023, me objekt: “*Blerje ushqime*”, me fond limit 10.000.000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra e Zhvillimit Shkodër.

II.2. Në datën 11.05.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- |                       |                              |
|-----------------------|------------------------------|
| 1. “Nika” SHPK        | 9.586.360 lekë, skualifikuar |
| 2. “Sead - SGS” SHPK  | 9.632.260 lekë, skualifikuar |
| 3. “EL-Gjo-2006” SHPK | 9.983.870 lekë, kualifikuar  |

II.3. Në datën 26.05.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve.

II.4. Në datën 02.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 1271 protokollit e operatorit ekonomik “Sead - SGS” SHPK, duke kërkuar kualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “EL-Gjo-2006” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1271/2 datë 05.06.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Sead - SGS” SHPK, si dhe kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Sead - SGS” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “EL-Gjo-2006” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.6. Me anë të shkresës nr. 29 prot., datë 15.06.2023 me objekt: “*Kthim përgjigje*”, protokolluar me tonën me nr. 1271/3 prot, datë 19.06.2023, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Sead - SGS” SHPK, ku konstatohet se e ka refuzuar atë për shkak se është paraqitur jashtë afatit pranë autoritetit kontraktor.

### III

Komisioni i Prokurimit Publik pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “Sead SGS” SHPK për kualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, si dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “EL-Gjo-2006” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet fillimisht në respektimin e kushteve formale të paraqitjes së ankesës nga ana e operatorit ekonomik ankimues njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Konkretisht, KPP vëren se,

III.1.1. Në datën 22.03.2023 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-62788-03-17-2023, me objekt: “*Blerje ushqime*”, me fond limit 10.000.000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra e Zhvillimit Shkodër.

III.1.2. Në datën 11.05.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

4. “Nika” SHPK	9.586.360 lekë, skualifikuar
5. “Sead - SGS” SHPK	9.632.260 lekë, skualifikuar
6. “EL-Gjo-2006” SHPK	9.983.870 lekë, kualifikuar

III.1.3. Në datën 26.05.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve.

III.1.4. Në datën 02.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. 1271 protokolli e operatorit ekonomik “Sead - SGS” SHPK, duke kërkuar kualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe skualifikimin e operatorit ekonomik “EL-Gjo-2006” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si

dhe është publikuar formulari i publikimit nr. prot 1271/2 datë 05.06.2023, lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “Sead - SGS” SHPK, si dhe kriteret për të cilat operatori ekonomik ankimues “Sead - SGS” SHPK pretendon, se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “EL-Gjo-2006” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit.

III.1.6. Me anë të shkresës nr. 29 prot., datë 15.06.2023 me objekt: “*Kthim përgjigje*”, protokolluar me tonën me nr. 1271/3 prot, datë 19.06.2023, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik aktin e trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik “Sead - SGS” SHPK, ku konstatohet se e ka refuzuar atë për shkak se është paraqitur jashtë afatit pranë autoritetit kontraktor.

III.1.7. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “*Afatet për ankimim*” të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se:

*“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.*

*Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.*

*7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.*

*8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.*

III.1.8. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikohet shprehimisht se: “*1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

Neni 112, pikat 1 dhe 2 të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, parashikon shprehimisht se: “*1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.*

*2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”.*

III.1.9. Në nenin 97 pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, parashikohet:

*“2. Në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit/entit kontraktor:*

a) brenda 10 (dhjetë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) brenda 7 (shtatë) ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit, ose publikimi i njoftimi të anulimit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar.”

III.1.10. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar qartë në nenin 110, pikat 2 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret, referuar verifikimeve në Sistemin e Prokurimit Elektronik, u konstatua se autoriteti kontraktor ka publikuar “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraparak” të procedurës në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) në datë 26.05.2023.

KPP vëren, se operatori ekonomik ankimues “Sead - SGS” SHPK, ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në datën 02.06.2023, pra jashtë afateve të ankimimit.

Në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje të ankimuesit nenin 111, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon shprehimisht se: *“Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik”*. Në rastin konkret ankesa e operatorit ekonomik ankimues rezulton, se është dorëzuar jashtë afateve ligjore të përcaktuara në nenin 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”*, pasi nga ana e autoritetit kontraktor në datë 26.05.2023, është publikuar “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraparak” në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në rastin konkret, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit dhe përfundon në ditën e 7-të.

Pra, afati i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik, ka filluar në ditën e publikimit të njoftimit të fituesit paraparak të procedurës së prokurimit datë 26.05.2023, ndërkohë që ankesa e paraqitur nga ankimuesi pranë Komisionit të Prokurimit Publik është në datë 02.06.2023, pra është jashtë afatit 7 ditor të përcaktuar në ligj duke mos u legjitimuar *ratione temporis*.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Në rastin konkret, ankesa e operatorit ekonomik ankimues “Sead - SGS” SHPK, është paraqitur pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, jashtë afateve të parashikuara ligjore të ankimimit.

Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: *“Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji”*.

Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave 57 Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Sead - SGS” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-62788-03-17-2023, me objekt: “Blerje ushqime”, me fond limit 10.000.000 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 11.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Qendra e Zhvillimit Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Sead - SGS” SHPK.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiovent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**